

Holiness to the Lord in Everyday Life

By Elder Gerrit W. Gong
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Shenjtëri Zotit në Jetën e Përditshme

Nga Plaku Gerit W. Gong,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

October 2024 general conference

Holiness to the Lord makes daily living sacred. It draws us closer and happier to the Lord and each other.

Our recent Gong family reunion included a fun talent show, complete with a dad jokes contest.

But this contest was unusual. On one team was Grandpa (me) and two of the grandchildren, ages 12 and 11. On the other team was an artificial intelligence (AI) program prompted by a cousin to tell dad jokes in the style of Gerrit W. Gong. Grandpa Gerrit Gong versus AI Gerrit Gong.

The grandchildren and I went first.

What do you call a dinosaur who crashes his car? Tyrannosaurus Wrecks.

AI Gerrit Gong was instructed—think like Gerrit W. Gong. Talk like him.

AI Gerrit Gong—“Here is a dad joke as if spoken by Gerrit W. Gong, embracing his warm, thoughtful, and uplifting style: Why did the humble tree make people smile? Because it was rooted in love and reached out with branches of kindness. Like that tree, we too can find strength in our roots and joy in extending kindness to others.”

Well, what do you think? That’s why they’re called dad jokes.

All around us are opportunities to laugh, delight, see with grateful eyes. Ours is a gospel of joy and holiness in everyday life. Holiness sets things apart for sacred purpose. But holiness also invites us to infuse daily living with the sa-

Shenjtëria ndaj Zotit e bën të shenjtë të jetuarit e përditshëm. Ajo na bën më të afërt e më të lumtur me Zotin dhe me njëri-tjetrin.

Grumbullimi ynë si familje Gong herën e fundit përfshiu një shfaqje argëtuese talentesh, bashkë me një konkurs gjëzash komike me lojërë fjalësh.

Por ky konkurs ishte i pazakontë. Në njërën skuadër ishin gjyshi (unë) dhe dy mbesat, në moshën 12 dhe 11 vjeçe. Në skuadrën tjetër ishte një program inteligjence artificiale (IA), të cilin e nxiste një kushëri të thoshte gjëza komike sipas stilit të Gerit W. Gongut. Gjyshi Gerit Gong i vërtetë kundër Gerit Gongut të inteligjencës artificiale.

Mbesat dhe unë filluam të parët.

Çfarë e quan një dinozaur me gërshtë në dorë? Berberosaurus.

Gerit Gongut artificial iu dha udhëzimi – mendo si Gerit W. Gongu. Fol si ai.

Gerit Gongu i inteligjencës artificiale: “Ja një gjëzë komike siç do ta thoshte Gerit W. Gongu, duke përfshirë stilin e tij të ngrohtë, plot mendim dhe që të ngre moralisht: ‘Përse i bëri pema e përlulur njerëzit të buzëqeshnin?’ Sepse ishte e rrënjësor në dashuri dhe i zgjati degët e mirësisë. Si ajo pemë, edhe ne mund të gjejmë forcë në rrënjët tona dhe gëzim kur u zgjatim mirësi të tjerëve.”

Pra, si ju duken? Kjo është arsyeja përse quhen gjëza komike.

Kudo përreth nesh ka mundësi për të qeshur, për t’u kënaqur, për të parë me sy mirënjohës. I yni është një ungjill i gëzimit dhe shenjtërisë në jetën e përditshme. Shenjtëria i vëçon gjërat për një qëllim të shenjtë. Por shenjtëria gjithashtu

cred—to rejoice in daily bread amidst this world’s thistles and thorns. To walk with the Lord, we must become holy, for He is holy, and to help us become holy, the Lord invites us to walk with Him.

We each have a story. As Sister Gong and I meet you—Church members and friends in many places and circumstances—your stories of holiness to the Lord in everyday life inspire us. You live seven Cs: communion with God, community and compassion with each other, commitment and covenant with God, family, and friends—centered in Jesus Christ.

Growing evidence highlights this striking fact: religious believers are on average happier, healthier, and more fulfilled than those without spiritual commitment or connection. Happiness and life satisfaction, mental and physical health, meaning and purpose, character and virtue, close social relationships, even financial and material stability—on each measure, religious practitioners flourish.

They enjoy better physical and mental health and greater life satisfaction across all ages and demographic groups.

What researchers call “religious structural stability” offers clarity, purpose, and inspiration amidst life’s twists and turns. The household of faith and community of Saints combat isolation and the lonely crowd. Holiness to the Lord says no to the profane, no to snarky cleverness at others’ expense, no to algorithms that monetize anger and polarization. Holiness to the Lord says yes to the sacred and reverent, yes to our becoming our freest, happiest, most authentic, best selves as we follow Him in faith.

What does holiness to the Lord in everyday life look like?

Holiness to the Lord in everyday life looks like two faithful young adults, married for a year, sharing with authenticity and vulnerability gospel covenants, sacrifice, and service in their unfolding lives.

She begins, “In high school, I was in a dark place. I felt like God wasn’t there for me. One night, a text from a friend said, ‘Hey, have you

na fton ta mbushim të jetuarit e përditshëm me gjëra të shenjta – të gëzohemi nga buka e përditshme mes ferrave dhe gjembave të kësaj bote. Për të ecur me Zotin, duhet të bëhemi të shenjtë, sepse Ai është i shenjtë; dhe që të na ndihmojë të bëhemi të shenjtë, Zoti na fton të ecim me Të.

Secili prej nesh e ka një histori. Teksa Mostra Gong dhe unë takohemi me ju, anëtarët dhe miqtë e Kishës në shumë vende dhe rrethana, na frymëzojnë historitë tuaja me shenjtëri ndaj Zotit në jetën e përditshme. Ju i jetoni të shtata kërkesat: afërsi me Perëndinë; bashkësi dhe dhembshuri me njëri-tjetrin; përkushtim dhe besëlidhje me Perëndinë, familjen dhe miqtë – qendëzim të Jezu Krishti.

Prova gjithnjë e në rritje e theksojnë këtë fakt befasues: besimtarët janë mesatarisht më të lumtur, më të shëndetshëm dhe më të përbushur se njerëzit pa zotim ose lidhje shpirtërore. Lumturia dhe kënaqësia në jetë, shëndeti mendor e fizik, kuptimi dhe qëllimi, karakteri dhe virtyti, marrëdhëniet e ngushta shoqërore, madje dhe qëndrueshmëria financiare e materiale – në secilën kategori, praktikuesit e një besimi fetar lulëzojnë.

Ata gëzojnë shëndet më të mirë fizik e mendor dhe kënaqësi më të madhe në jetë në të gjitha moshat dhe grupet demografike.

Ajo që shkencëtarët e quajnë “qëndrueshmëria strukturore fetare”, ofron qartësi, qëllim e frymëzim mes dredhave dhe kthesave të jetës. Një vatër familjare besimi dhe komuniteti i shenjtoreve e luftojnë izolimin dhe turmën e vetmuar. Shenjtëria ndaj Zotit u thotë jo gjërave profane, jo zgjuarsisë poshtëruese në kurriz të të tjerëve, jo algoritmeve të internetit që i shndërojnë në të ardhura zemërimin dhe polarizimin shoqëror. Shenjtëria ndaj Zotit u thotë po gjërave të shenjta dhe nderuese, po shndërrimit tonë në veten tonë më të lirë, më të lumtur, më autentike, më të mirë teksa e ndjekim Atë me besim.

Me çfarë ngjan shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme?

Shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme ngjan me dy të rinj në moshë madhore besnikë, të martuar prej një viti, që po flasin me vërtetësi dhe zemër në dorë për besëlidhjet e ungjillit, sakrificën dhe shërbimin teksa jeta e tyre shpaloset para tyre.

Ajo fillon: “Në shkollë të mesme pata një periudhë të zymtë. Ndieja se nuk e kisha pranë Perëndinë. Një natë, në një mesazh në telefon nga

read Alma 36 ever?

“As I started reading,” she said, “I was overcome with peace and love. I felt like I was being given this big hug. When I read Alma 36:12, I knew Heavenly Father saw me and knew exactly how I was feeling.”

She continues, “Before we got married, I was honest with my fiancé that I didn’t have a great testimony of tithing. Why did God need us to give money when others had so much to give? My fiancé helped explain it’s not about money but following a commandment asked of us. He challenged me to start paying tithing.

“I really saw my testimony grow,” she said. “Sometimes money gets tight, but we saw so many blessings, and somehow paychecks were enough.”

Also, “in my nursing class,” she said, “I was the only member of the Church and the only one married. Many times I left class frustrated or crying because I felt classmates singled me out and made negative comments about my beliefs, my wearing my garments, or my being married so young.”

Yet she continues, “This past semester I learned how to better voice my beliefs and be a good gospel example. My knowledge and testimony grew because I was tested in my ability to stand alone and be strong in what I believe.”

The young husband adds, “Before my mission I had offers to play college baseball. Making the difficult decision, I put those offers aside and went to serve the Lord. I wouldn’t trade those two years for anything.

“Returning home,” he said, “I expected a difficult transition but found myself stronger, faster, and healthier. I was throwing harder than when I left. I had more offers to play than when I left, including my dream school. And, most importantly,” he said, “I rely upon the Lord more than ever.”

He concludes, “As a missionary I taught that Heavenly Father promises us power in our prayers, but sometimes I forget that for myself.”

Our treasury of missionary holiness-to-the-

një shoqe thuhej: ‘Ej, a e ke lexuar ndonjëherë kapitullin tek Alma 36?’

Teksa fillova ta lexoja”, – tha ajo, – “më kaploi pagja dhe dashuria. Ndjeva sikur po më jepej një përfaqim i madh. Kur lexova tek Alma 36:12, e dija se Ati Qiellor më shihte dhe e dinte saktësisht se si po ndihesha.”

Ajo vazhdon: “Përpara se të martoheshim, u tregova e sinqertë me të fejuarin për faktin se nuk kisha ndonjë dëshmi të madhe për të dhjetën. Përse kishte nevojë Perëndia që ne të jepnim para, kur të tjerët kishin kaq shumë për të dhënë? I fejuari im më ndihmoi duke shpjeguar se kjo nuk ka lidhje me paratë, por me zbatimin e një urdhërimi që na kërkohet. Ai më hodhi sfidën që të filloja ta paguaja të dhjetën.

Vërtet e pashë dëshminë time të rritej”, – tha ajo. “Nganjëherë jemi ngushtë për para, por pamë aq shumë bekime dhe disi rrogat na mjaftonin.”

Gjithashtu, “Në degën e infermierisë”, – tha ajo, – “isha e vetmja anëtare e Kishës dhe e vetmja e martuar. Shumë herë largohesha nga mësimi e acaruar ose duke qarë ngaqë ndieja se pjesëtarët e tjerë të klasës më veçonin dhe bënë komente negative rreth bindjeve të mia fetare, mbajtjes së veshjeve të brendshme të tempullit ose rreth faktit që isha martuar aq e re.”

Prapëseprapë, ajo vijon: “Këtë semestër që kaloi, mësova se si t’i shprehja më mirë bindjet e mia fetare dhe të isha një shembull i mirë i ungjillit. Njohuria dhe dëshmia ime u rritën ngaqë u vura në provë lidhur me aftësinë time për të qëndruar e vetme dhe për të qenë e fortë në atë që besoj.”

Bashkëshorti i ri në moshë shton: “Përpara misionit, kisha oferta që të luaja bejzboll në kolegji. Duke marrë vendimin e vështirë, unë i lashë mënjatë ato oferta dhe shkova t’i shërbeja Zotit. Nuk do t’i këmbesha ata dy vjet me asgjë.

Me kthimin në shtëpi”, – tha ai, – “prisja një fazë të vështirë kalimtare, por e pashë veten më të fortë, më të shpejtë dhe më të shëndetshëm. Po e hidhja topin më fort sesa kur u largova. Pata më shumë oferta për të luajtur sesa kur u largova, përfshirë edhe nga shkolla e ëndrrave të mia. Më e rëndësishmja”, – tha ai, – “unë mbështetem te Zoti më shumë se kurrë.”

Ai e mbyll: “Si misionar mësova se Ati Qiellor na premton fuqi nga lutjet tona, por nganjëherë e harroj këtë gjë kur bie fjala te vetja.”

Thesari ynë i bekimeve të marra kur i japim

Lord blessings is rich and full. Finances, timing, and other circumstances are often not easy. But when missionaries of all ages and backgrounds consecrate holiness to the Lord, things can work out in the Lord's time and way.

Now with a 48-year perspective, a senior missionary shares, "My dad wanted me to get a college education, not go on a mission. Shortly after that, he had a heart attack and died at age 47. I felt guilty. How could I make things right with my father?"

"Later," he continues, "after I decided to serve a mission, I saw my father in a dream. Peaceful and contented, he was happy I would serve."

This senior missionary continues, "As-Doctrine and Covenants section 138 teaches, I believe my father could serve as a missionary in the spirit world. I picture my father helping our great-grandfather, who left Germany at age 17 and was lost to the family, be found again."

His wife adds, "Among the five brothers in my husband's family, the four who served missions are the ones with college degrees."

Holiness to the Lord in everyday life looks like a young returning missionary who learned to let God prevail in his life. Earlier, when asked to bless someone who was very sick, this missionary said, "I have faith; I will bless him to recover. Yet," the returning missionary says, "I learned in that moment to pray not for what I wanted but for what the Lord knew the person needed. I blessed the brother with peace and comfort. He later passed away peacefully."

Holiness to the Lord in everyday life feels like a spark arcing across the veil to connect, comfort, and strengthen. An administrator at a major university says he feels individuals he knows only by reputation praying for him. Those individuals devoted their lives to the university and continue to care about its mission and students.

A sister does her best each day, after her husband was unfaithful to her and the children. I deeply admire her and others like her. One day while folding laundry, her hand on a stack of garments, she sighed to herself, "What's the

shenjtëri Zotit përmes shërbimit misionar, është i pasur dhe i mbushur plot. Financat, koha dhe rrethana të tjera shpesh nuk janë të lehta. Por kur misionarët e të gjitha moshave dhe prejardhjeve i përkushtojnë shenjtëri Zotit, gjërat mund të zgjidhen në kohën dhe mënyrën e Zotit.

Tani, për një përvojë që ndodhi përpara 48 vjetësh, një misionar në moshë tregon: "Babi im donte që unë të merrja arsimim në kolegji dhe të mos shkoja në mision. Pak kohë pas kësaj, ai pësoi një infarkt dhe vdiq në moshën 47-vjeçare. U ndjeva fajtor. Si mund t'i rregulloja gjërat me atin tim?"

Më vonë", – vijon ai, – "pasi vendosa të shërbeja në një mision, pashë babanë në ëndërr. Plot paqe dhe kënaqësi, ai ishte i lumtur që do të shërbeja."

Ky misionar në moshë vazhdon: "Siç na mësohet te Doktrina e Besëlidhje, seksioni 138, unë besoj se ati im mund të shërbente si misionar në botën e shpirtave. E imagjinoj babanë tim duke ndihmuar stërgjyshin tonë, i cili u largua nga Gjermania në moshën 17-vjeçare dhe ishte i humbur për familjen, që të gjendej përsëri."

Bashkëshortja e tij shton: "Mes pesë vëllezërve në familjen e bashkëshortit tim, ata katër që shërbyen në mision, janë ata që morën diploma kolegji."

Shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme ngjan me një misionar të ri në moshë, i kthyer nga misioni, i cili mësoi ta lejojë Perëndinë të triumfojë në jetën e tij. Më parë, kur iu kërkuar të bekonte dikë që ishte shumë i sëmurë, ky misionar tha: "Kam besim; do ta bekoj që të shërohet. Prapëseprapë", – thotë misionari i kthyer, – "mësova në atë çast që të lutesha jo për atë që dëshiroja, por për atë që Zoti e dinte se kishte nevojë personi. E bekoja vëllanë me paqe e ngushëllim. Më vonë ai ndërroi jetë paqësisht."

Shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme ndihet si një shkëndijë që kalon përmes velit për të lidhur, ngushëlluar e forcuar. Një administrator në një universitet të madh thotë se i ndien individët që i njeht vetëm nga emri, të luten për të. Ata individë ia përkushtuan jetën universitetit dhe vazhdojnë të kujdesen për misionin dhe studentët e tij.

Një motër bën gjithçka mundet çdo ditë, pasi bashkëshorti që jo besnik ndaj saj dhe fëmijëve. I admiroj thellësisht atë dhe njerëz të tjerë si ajo. Një ditë, ndërsa po paloste rrobat e lara, me dorën mbi një grumbull veshjesh të brendshme

point?” She felt a tender voice assure her, “Your covenants are with me.”

For 50 years, another sister yearned for a relationship with her father. “Growing up,” she says, “there were my brothers and my dad, and then there was me—the only daughter. All I ever wanted was to be ‘good enough’ for my dad.

“Then my mom passed away! She was my only liaison between my dad and me.

“One day,” the sister said, “I heard a voice say, ‘Invite your dad and take him to the temple with you.’ That was the beginning of a twice-a-month date with my daddy to the house of the Lord. I told my dad I loved him. He told me he loved me too.

“Spending time in the house of the Lord has healed us. My mom could not help us on earth. It took her being on the other side of the veil to help mend what was broken. The temple completed our journey to wholeness as an eternal family.”

The father says, “The temple dedication was a great spiritual experience for me and my only daughter. Now we attend together and feel our love strengthen.”

Holiness to the Lord in everyday life includes tender moments when loved ones pass. Earlier this year, my dear mother, Jean Gong, slipped into the next life days before her 98th birthday.

If you asked my mother, “Would you like rocky road, white chocolate ginger, or strawberry ice cream?” Mom would say, “Yes, please, may I taste each one?” Who could say no to your mother, especially when she loved all of life’s flavors?

I once asked Mom which decisions had most shaped her life.

She said, “Being baptized a member of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints and moving from Hawaii to the mainland, where I met your father.”

Baptized as a 15-year-old, the only member of her large family to join our Church, my mother had covenant faith and trust in the Lord that blessed her life and all our family generations. I

të tempullit, ajo psherëtiu me vete: “Ç’vlerë kanë?” Ajo ndjeu një zë të butë që i dha siguri: “Besëlidhjet e tua janë me mua”.

Për 50 vjet një motër tjetër që e dëshiruar të krijonte një marrëdhënie me të atin e saj. “Ndërkohë që rritesha”, – thotë ajo, – “ishin vëllezërit e mi dhe babi im si një grup, dhe pastaj vija unë, bija e vetme. Gjithçka që kisha dëshiruar gjithmonë, ishte që të isha ‘e mirë mjaftueshëm’ për babin tim.

Më pas, mami ndërroi jetë! Ajo ishte e vetmja ndërldhëse midis meje dhe babit.

Një ditë”, – tha motra, – “dëgjova një zë të thoshte: ‘Ftoj babin dhe merre me vete në tempull’. Ai ishte fillimi i një takimi dy herë në muaj me babin në shtëpinë e Zotit. I thashë babit tim se e doja. Edhe ai më tha se më donte.

Shpenzimi i kohës në shtëpinë e Zotit na ka shëruar. Mami nuk mundi të na ndihmonte në tokë. U desh që ajo të ishte në anën tjetër të velit që të ndihmonte për të ndrequr atë që ishte e thyer. Tempulli e plotësoi rrugëtimin tonë drejt shërimit tërësor si një familje e përjetshme.”

Babai thotë: “Përkushtimi i tempullit ishte një përvojë e shkëlqyer shpirtërore për mua dhe për bijën time të vetme. Tani ne e frekuentojmë së bashku dhe e ndiejmë dashurinë të na forcohet.”

Shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme përfshin çaste të dhembshura kur ndërrojnë jetë njerëzit e dashur. Në fillim të këtij viti, nëna ime e dashur, Xhin Gongu, qetësisht e paqetësisht kaloi në jetën tjetër, pak ditë përpara ditëlindjes së saj të 98-të.

Po ta pyesnit nënën time: “A do akullore me çokollatë dhe arra, me çokollatë të bardhë dhe xhenxhefil, apo akullore me luleshtrydhe?” Mami do të thoshte: “Po, të lutem, a mund t’i provoj të gjitha?” Kush mund t’i thoshte jo nënës sime, veçanërisht kur asaj i pëlqenin shumë të gjitha shijet e jetës?

Njëherë e pyeta mamin se cilat vendime i kishin dhënë më shumë trajtë jetës së saj.

Ajo tha: “Pagëzimi si anëtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe shpërngulja nga Havai në pjesën kontinentale të SHBA-së, ku u takova me babanë tënd”.

E pagëzuar si një 15-vjeçare, e vetmja anëtare e familjes së saj të madhe që u bashkua me Kishën tonë, nëna ime pati besim besëlidhës dhe mirëbesim te Zoti që e bekuan jetën e saj dhe tërë

miss my mother, as you miss members in your family. But I know my mother is not gone. She is just not here now. I honor her and all who pass as valiant examples of everyday holiness to the Lord.

Of course, holiness to the Lord in everyday life includes coming more often to the Lord in His holy house. This is true whether we are Church members or friends.

Three friends came to the Bangkok Thailand Temple open house.

“This is a place of super healing,” said one.

In the baptistry, another said, “When I am here, I want to be washed clean and never sin again.”

The third said, “Can you feel the spiritual power?”

With nine sacred words, our temples invite and proclaim:

“Holiness to the Lord.

“The House of the Lord.”

Holiness to the Lord makes daily living sacred. It draws us closer and happier to the Lord and each other and prepares us to live with God our Father, Jesus Christ, and our loved ones.

As did my friend, you may wonder if your Heavenly Father loves you. The answer is a resounding, absolute yes! We can feel His love as we make holiness to the Lord ours each day, happy and forever. May we do so, I pray in the sacred name of Jesus Christ, amen.

brezat e familjes sonë. Më merr malli për nënën time, ashtu siç ju merr malli ju për pjesëtarë në familjen tuaj. Por e di se nëna ime nuk është zhdukur. Ajo thjesht nuk është këtu tani. E nderoj atë dhe të gjithë ata që ndërrojnë jetë si shembuj të guximshëm të shenjtërisë së përditshme ndaj Zotit.

Sigurisht, shenjtëria ndaj Zotit në jetën e përditshme përfshin ardhjen më shpesh te Zoti në shtëpinë e Tij të shenjtë. Kjo është e vërtetë, pavarësisht a jemi anëtarë apo miq të Kishës.

Tre miq të Kishës erdhën në shtëpinë e hapur të Tempullit të Bangkokut në Tajlandë.

“Ky është një vend ku shëroresh i tëri”, – tha njëri.

Në pagëzimore, një tjetër tha: “Kur jam këtu, dua të lahem që të pastrohem dhe kurrë të mos mëkatoj përsëri”.

I treti tha: “A e ndien fuqinë shpirtërore?”

Me pesë fjalë të shenjta, tempujt tanë ftojnë dhe shpallin:

“Shenjtëri Zotit.

Shtëpia e Zotit.”

Shenjtëria ndaj Zotit e bën të shenjtë të jetuarit e përditshëm. Ajo na bën më të afërt e më të lumtur me Zotin dhe me njëri-tjetrin; dhe na përgatit të jetojmë me Perëndinë, Atin tonë, me Jezu Krishtin dhe me njerëzit tanë të dashur.

Sikurse mikja ime, ju mund të pyesni veten a ju do Ati Qiellor. Përgjigja është një po kumbuese, absolutisht po! Ne mund ta ndiejmë dashurinë e Tij ndërsa e bëjmë shenjtërinë ndaj Zotit diçka tonën çdo ditë, të lumtur dhe përgjithmonë. Veprofshim të gjithë kështu, unë lutem në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen.